

**KODI GLOBAL I SJELLJES PËR MBLEDHJEN DHE PËRDORIMIN E INFORMACIONEVE RRETH DHUNËS
SEKSUALE SISTEMATIKE DHE TË NDËRLIDHUR ME KONFLIKTIN**
13 prill 2022

Parathënie

Ky është një Kod vullnetar i Sjelljes që përmbledh standardet minimale ekzistuese për mbledhjen dhe përdorimin e sigurtë, efektiv dhe etik të informacioneve të viktimës ose të mbijetuarit/es ("të mbijetuarit/es")¹ në lidhje me dhunën seksuale sistematike dhe të ndërlidhur me konfliktin ("DhSSK").² Ky Kod u drejtohet atyre që dokumentojnë, hetojnë, raportojnë, hulumtojnë, monitorojnë dhe që në mënyra të tjera mbledhin ("mbledhja") dhe përdorin informacion të tillë.

Ky Kod është i rrënjësor në të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtat themelore të njeriut të të mbijetuarve/ave, siç janë e drejta për dinjitet, privatësi, shëndet, siguri, qasje në drejtësi, në të vërtetën dhe në mjete efektive juridike. Si i tillë, Kodi pasqyron standardet thelbësore universale dhe të panegociueshme, të cilat duhet të zbatohen nga të gjithë aktorët në të gjitha kontekstet për të ruajtur një qasje të përqendruar në të mbijetuarit/at. Kodi përfshinë standarde që zbatohen si për individët ashtu edhe për organizatat, të cilat duhet t'i integrojnë këto standarde në sistemet, politikat, procedurat, kontratat dhe praktikatat e tyre.

¹Konceptet kryesore të përkufizuara për qëllimet e Kodit

"Të mbijetuarit/at" dhe/ose "viktimat": Kodi përdor termin "i/e mbijetuar" pasi më së shpeshti konsiderohet fuqizues. Termat "viktimë" dhe "i/e mbijetuar" mund të kenë kuptime të ndryshme në mjediset dhe gjuhët të ndryshme, dhe personat që kanë përjetuar dhunë mund të preferojnë njërin term në vend të tjetrit, ose mund të mos preferojnë asnjërin. Zgjedhjet e të mbijetuarve/ave në lidhje me identitetin e tyre duhet të respektohen dhe të pasqyrohen nga njerëzit përreth tyre. Është gjithashtu e rëndësishme të pranohet fakti se disa viktima nuk i mbijetojnë dhunës. Derisa Kodi fokusohet në punën me të mbijetuarit/at, aspekte të Kodit zbatohen edhe për mbrojtjen e privatësisë dhe të drejtave të viktimave që nuk kanë mbijetuar.

² Dhuna seksuale sistematike dhe e ndërlidhur me konfliktin (DhSSK): Ky është një përkufizim i gjerë. DhSSK përfshin përdhunimin, skllavërinë seksuale, prostitucionin e detyruar, shtatzëninë e detyruar, abortin e detyruar, sterilizimin e detyruar, martesën e detyruar, trafikimin e personave me qëllim të dhunës seksuale dhe/ose shfrytëzimit seksual, dhe çdo formë tjetër të dhunës seksuale të seriozitetit të ngjashëm të kryer ndaj çdo personi, kur kjo sjellje lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me një konflikt të armatosur. Ajo përfshin gjithashtu akte të tilla edhe gjatë kohës së paqes ose në fazat e tranzicionit, kur ato janë pjesë e dhunës sistematike, shtypëse, të strukturuar ose politike, dhe kur një dhunë e tillë përdoret për të terrorizuar ose shkatërruar komunitete. DhSSK përfshin, por nuk kufizohet vetëm në dhunën seksuale, që përbën krim ndërkombëtar të gjenocidit, krim kundër njerëzimit ose krime të luftës.

Ky Kod nuk është licencë ose nxitje për të mbledhur dhe përdorur informacion mbi DhSSK. Ai nuk përmbledhë dhe nuk zëvendëson udhëzimet teknike të rëndësishme në sektorë të ndryshëm. Kodi nuk është një rrugë e shkurtër për t'u bërë apo për të mbetur kompetent në këtë punë, e cila duhet të kryhet me përgjegjësi dhe në një mënyrë të përqendruar te i/e mbijetuari/a.

Kodi është formuluar në formën kolektive "ne" për të theksuar angazhimin tonë vullnetar për të punuar së bashku në ndërtimin dhe ruajtjen e praktikave më të sigurta dhe më efektive të përqendruara te të mbijetuarit/at. "Ne" përfaqëson parimin e rëndësishëm "asgjë që ka të bëjë me ne, pa ne, nuk është për ne", si dhe punën bashkë me të mbijetuarit/at, shumë prej të cilëve/ave janë gjithashtu dokumentues/e, aktivistë/e, avokatë/e, punonjës/e shëndetësorë/e, këshilltarë/e, etj., për të promovuar të drejtat dhe zgjedhjet e tyre. Kodi është hartuar përmes një procesi të gjerë konsultativ global, duke i përfshirë të mbijetuarit/at në çdo fazë. "Ne" u referohet individëve, ekipeve, palëve të interesuara dhe organizatave në dhe përtej konteksteve të ndryshme, duke përfshirë qeveritë, organizatat ndërqeveritare, shoqërinë civile dhe financuesit. "Ne" rrallë punojmë të vetëm dhe standardet e përbashkëta nëpër sektorë mund t'u mundësojnë individëve, ekipeve dhe organizatave të punojnë së bashku në mënyrë të përgjegjshme.

Ky Kod i Sjelljes zbatohet:

- për mbledhjen e informacionit në mënyrë të drejtpërdrejtë, të tërthortë, personalisht ose në distancë, nga dhe për të mbijetuarit/at në çfarëdo forme (duke përfshirë atë digjitale, me shkrim, me gojë, audio-vizuale, fotografike) dhe transportimin, transferimin, ruajtjen, përdorimin, ndarjen ose publikimin e mëpastajmë të tij,
- në lidhje me DhSSK (të përcaktuar në mënyrë të gjerë dhe gjithëpërfshirëse),
- për çdo qëllim që përfshin ndarjen ose publikimin e një informacioni të tillë, por duke përjashtuar mbledhjen e informacionit për qëllimin e përkujdesjes së menjëhershme ose mbështetjes së të mbijetuarve/ave.

Prandaj, duhet të zbatohet, për shembull, nga hetuesit, dokumentuesit, monitoruesit dhe aktivistët e të drejtave të njeriut, përfshirë hetuesit e burimeve të hapura; hetuesit penalë; zyrtarët dhe ekspertët të tjerë që mbledhin, kërkojnë ose marrin informacione për DhSSK, përfshirë zyrtarët e imigracionit dhe azilit si dhe ekspertët mjeko-ligjorë; gazetarët; studiuesit; përkthyesit; dhe organizatat mbështetëse me bazë në komunitet, grupet e të mbijetuarve/ave dhe punonjësit humanitarë që mbledhin dhe shpërndajnë ose publikojnë informacione të tilla (përveç për qëllime të përkujdesjes dhe mbështetjes së menjëhershme). Ai duhet të zbatohet gjithashtu nga ata që emërojnë, menaxhojnë, financojnë dhe mbështesin ose lehtësojnë në ndonjë formë mbledhjen dhe përdorimin e një informacioni të tillë, përfshirë politikëbërësit. Kjo nuk është një listë e plotë.

Fokusi aktual i Kodit në DhSSK buron nga origjina e nismës për të identifikuar dhe nxjerrë në pah standardet e DhSSK-së dhe disa faktorë specifikë për dhunën seksuale, siç janë qëndrimi shoqëror dhe stigma që i dëmtojnë edhe më shumë të mbijetuarit/at. Megjithatë, shumë nga standardet në Kod zbatohen njëjloj për mbledhjen dhe përdorimin e informacionit nga ose për të mbijetuarit/at e krimeve të tjera dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Shprehja "i/e mbijetuar" përfshin të mbijetuarit/at e të gjitha moshave, përfshirë të rriturit dhe fëmijët (personat nën 18 vjeç³), dhe të gjitha gjinitë dhe identitetet.⁴ DhSSK ka ndikim joproporcional mbi gratë dhe vajzat (që ndodhen brenda një tërësie më të gjerë të dhunës që buron nga pabarazitë sistematike gjinore dhe të tjera), gjë që rezulton në pasojë të shumta të dëmshme në jetën e tyre dhe ndikon në punën tonë. Ne duhet të marrim gjithashtu parasysh në punën tonë edhe gamën e gjërë të mbijetuarve të tjerë, siç janë personat me aftësi të kufizuara, personat nga komunitetet LGBTQI+,⁵ burrat dhe djemtë, si dhe mbivendosjet në këto identitete.

Kodi thekson nevojën për të njohur individualitetin e të mbijetuarve/ave dhe për të shmangur bërjen e supozimeve bazuar në grupet të cilave ata/ato u përkasin apo në ndonjë aspekt të vetëm të identitetit të tyre.⁶ Për shembull, "fëmijët" nuk janë një grup homogjen dhe përfshijnë persona që janë shumë të ndryshëm për nga mosha, pjekuria, qëndrueshmëria, arsimimi, gjinia, identitetet dhe situatat e tjera. Përshtatja e qasjes sonë ndaj pikave të forta, nevojave dhe realiteteve individuale të të mbijetuarve/ave mundëson mbledhjen dhe përdorimin e informacionit në mënyrë më efektive dhe më të përqendruar në të mbijetuarit/at.

Përgatitja është thelbësore. Ne duhet të shmangim në mënyrë aktive mbledhjen dhe përdorimin e paplanifikuar të informacionit, veçanërisht nëse nuk i kemi sistemet, politikat, procedurat, vlerësimet e rrezikut dhe planet e nevojshme. Gjithashtu duhet të adresojmë mbështetjen tonë të tepruar të informacioni nga të mbijetuarit/at. Nëse të gjithë vendosim se kemi nevojë për informacione nga të mbijetuarit/at, ne krijojmë kërkesa dhe presione të shumta mbi të mbijetuarit/at dhe rrisim rreziqet e ekspozimit dhe ritraumatizimit. Sa herë që mundemi, duhet të kërkojmë informacion për DhSSK

³ Siç përcaktohet në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës të vitit 1989.

⁴ **Gjinia:** Në këtë Kod, "gjinia" i referohet përkufizimit sipas nenit 7(3) të Statutit të Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare: dy sekset, mashkull dhe femër, brenda kontekstit të shoqërisë. Ky përkufizim pranon konstruktin shoqëror të gjinisë dhe rolet, sjelljet, aktivitetet dhe karakteristikat që u atribuohen grave dhe burrave, si dhe vajzave dhe djemve. Narrativat e dëmshme gjinore ndikojnë në mënyrë disproporcionale te gratë dhe vajzat. Megjithatë, narrativat e dëmshme gjinore ndikojnë gjithashtu, për shembull, edhe te personat që janë jobinarë ose jokonform me normat gjinore; personat me orientime seksuale, identitete gjinore, shprehje të gjinisë, karakteristika të ndryshme të seksit, si dhe te burrat e djemtë.

⁵ Ndonëse akronimi **LGBTQI+** (lesbikë, homoseksual, biseksual, transgjor, queer dhe/ose në dyshim, interseksual dhe persona të tjerë që kanë identitet gjor ose orientim seksual jo-normativ) përfshin një gamë të gjerë individësh, ai nuk është shterues, dhe as nuk është një akronim standard i pranuar në mënyrë universale.

⁶ Njerëzit janë qenie komplekse dhe dinamike, me karakteristika,tribute ose identitete të shumta, që mbivendosen dhe që ndryshojnë. Ata shpesh përballen me më shumë se një formë të diskriminimit, ndikohen nga faktorë të gjendjes siç janë konflikti, zhvendosja, varfëria, pandemitë dhe sëmundjet, dhe si pasojë ose për arsye tjera përballen me rreziqe sigurie, shëndetësore, ligjore dhe të tjera. Kuptimi i këtyre faktorëve mund të na ndihmojë të kuptojmë më mirë të mbijetuarin/en, shkeljet që kanë përjetuar, rreziqet, sfidat dhe barrierat me të cilat përballen, të drejtat dhe dëshirat e tyre, si dhe nevojat e tyre për mbështetje, dhe të na ndihmojë të përshtatim siç duhet planet dhe qasjet tona.

Këto **karakteristika,tribute dhe identitete**,sidhe **format e diskriminimit** që lidhen me to me të cilat mund të përballen të mbijetuarit/at përfshijnë: moshën (përfshirë nivelin e pjekurisë, kapacitetet zhvillimore); seksin dhe gjininë (përfshirë identitetin dhe shprehjen gjinore (përfshirë atë transgjor, jobinar dhe jokonformues gjor), orientimin seksual, karakteristikat seksuale (përfshirë personat interseks)); racën; fenë; origjinën kombëtare; prejardhjen shoqërore; përkatësinë etnike (përfshirë grupet indigjene, kulturën dhe traditat); aftësinë e kufizuar; gjendjen apo statusin familjar; statusin e lindjes; klasën shoqërore, kastën ose statusin socio-ekonomik; gjendjen ose statusin shëndetësor; shtetësinë; statusin e refugjatit, emigrantit ose status tjetër të banimit; arsimimin dhe nivelin e shkrim-leximit; statusin ligjor; dhe bindjet, opinionet apo përkatësitë politike. Kjo nuk është një listë shteruese. Të mbijetuarit/at shpesh përballen me forma të shumfishta dhe të ndërlikuara të diskriminimit. Kur forma të shumta të diskriminimit dhe pabarazive mbivendosen, ato referohen si "**faktorë ndërseksionalë**".

nga burime të tjera përveç të mbijetuarve/ave (si p.sh. dëshmitarët që kanë parë faktet dhe raportet e ekspertëve) për të ulur presionin mbi të mbijetuarit/at.

Kodi pasqyron se nëse bëhet siç duhet, ata që mbledhin dhe përdorin informacion për DhSSK mund të shmangin zgjedhjen e gabuar midis të qenit të përqendruar në të mbijetuarit/at ose të qenit efektiv.

Të gjitha parimet dhe zotimet e Kodit janë të ndërlidhura, përforcojnë njëra-tjetrën dhe janë të rëndësishme. Radhitja numerike nuk nënkupton përparësi ose rëndësi.

PARIMET GJITHËPËRFSHIRËSE			
			
KUPTONI TË MBIJETUARIT/AT SI INDIVIDË	RESPEKTONI KONTROLLIN DHE AUTONOMINË E TË MBIJETUARIT/ES	JINI TË PËRGJEGJSHËM DHE KINI INTEGRITET	SHTONI VLERË OSE MOS E BËNI FARE

PARIMET E PËRGATITJES		
		
PËRGATITJA ËSHTË THEMELI	NJIHNI DHE KUPTONI KONTEKSTET	NDËRTONI SISTEME, AFTËSI DHE MBËSHTETJE

PARIMET E ZBATIMIT		
		
MBLEDHNI INFORMACIONE NGA BURIME TË TJERA	MERRNI KOHËN E NEVOJSHME, KRIJONI HAPËSIRË	SIGURONI NDËRVEPRIME ME RESPEKT DHE TË SIGURTA

PARIMET GJITHËPËRFSHIRËSE
<i>Këto janë parime gjithëpërfshirëse që zbatohen në të gjitha fazat e përgatitjes dhe zbatimit. Ato duhet të integrohen brenda çdo parimi të Kodit.</i>

PARIMI 1: KUPTONI TË MBIJETUARIT/AT SI INDIVIDË

1.1 Përshtatuni me individualitetin e të mbijetuarit/es: Ne respektojmë faktin që çdo i/e mbijetuar është unik/e. Ne do të përshtasim qasjen tonë sipas identiteteve, karakteristikave, grupeve dhe konteksteve specifike të tyre, siç janë mosha, gjinia, aftësitë zhvillimore, qëndrueshmëria, marrëdhëniet dhe lidhjet e tyre me të tjerët, gjendja socio-ekonomike dhe politike, si dhe diskriminimi me të cilin përballen. Ne e njohim faktin se këto elemente ndryshojnë me kalimin e kohës dhe sipas kontekstit, dhe se qasja jonë mund të ketë nevojë të ndryshohet në përputhje me rrethanat.

1.2 Kundër supozimet: Ne nuk do bëjmë supozime ose përgjithësime për të mbijetuarit/at ose përvojat e tyre, si për shembull se si 'duhet' të sillen ose të reagojnë, për cënueshmërinë e tyre, traumën, qëndrueshmërinë, gjininë, aftësitë e kufizuara, kapacitetin, pjekurinë, besueshmërinë, nevojat ose shqetësimet e tyre.

1.3 Pyesni të mbijetuarin/en: Pas punës fillestare përgatitore, ne do të pyesim të mbijetuarin/en, përfshirë edhe fëmijët e mbijetuar, për atë çfarë duan, prioritetet, shqetësimet, rreziqet dhe situatën aktuale. Ne do t'i respektojmë dhe do t'i pasqyrojmë këto për aq sa është e mundur brenda mandateve dhe burimeve tona.

1.4 Jepni përparësi sigurisë së të mbijetuarve/ave: Ne vazhdimisht do t'i japim përparësi sigurisë, mirëqenies dhe dinjitetit të të mbijetuarit/es përpara objektivave tona. Ne do të punojmë për të kuptuar rreziqet dhe pasojat, që mund të lindin për të mbijetuarit/at dhe për personat rreth tyre si rezultat i çdo kontakti me ne. Rreziqe të tilla mund të përfshijnë riviktimizimin, veprimet

hakmarrëse, stigmatizimin, rreziqet fizike, online, rreziqet për sigurinë e informacionit dhe komunikimit dhe rreziqet ligjore.

1.5 Identifikoni rreziqet e shtuara: Ne do të marrim masa paraprake shtesë dhe specifike të kujdesit kur ka rrezik të shtuar për dëm të mëtejshëm. Ne e kuptojmë që çdo individ mund të përballë me rreziqe të shtuara, të cilat mund të ndryshojnë me kalimin e kohës dhe sipas kontekstit. Rreziqe të shtuara mund të ketë për të mbijetuarit/at fëmijë, përfshirë fëmijët e lindur nga lufta dhe fëmijët e pashoqëruar, personat nga komunitetet LGBTQI+, personat me aftësi të kufizuara ose me shkrim-lexim të kufizuar, personat nga grupet indigjene ose të marginalizuara, si dhe për të tjerë.⁶

1.6 Mbështetni qasjen në drejtësi: Ne do të mbështesim të drejtën e të mbijetuarit/es për të ushtruar të drejtat e tij/saj (ose jo), siç janë e drejta në mjete juridike efektive, për të vërtetën, për qasjen në 'drejtësi' (sipas përkufizimit të dhënë nga vetë i/e mbijetuarit/a) dhe reparacionet transformuese. Ne nuk do të ndikojmë negativisht në prioritetet e të mbijetuarit/es, aftësinë për të avancuar ose kërkuar të drejtat e veta, apo në zgjedhjen për të marrë pjesë (ose jo) në proceset e llogaridhënies. Edhe pse të dhënat ose raportet e intervistave mund jenë të dobishme për të mbijetuarit/at në proceset e mëvonshme, ne do të zbusim rrezikun që metodologjia dhe të dhënat e intervistave të mëparshme të mund të përdoren për të argumentuar se rrëfimi i të mbijetuarit/es është jokonsistent ose që mbi të është ushtruar ndikim i papërshtatshëm.

1.7 Respektoni vet-identitetin: Ne do të respektojmë dhe reflektojmë zgjedhjen dhe shprehjen e identitetit të një të mbijetuarit/e (siç është gjinia, përemrat, aftësitë e kufizuara dhe karakteristika të tjera) dhe do të shmangim etiketimet ose karakterizimet që ofendojnë, sensacionalizojnë, marginalizojnë, stigmatizojnë, vënë në rrezik ose që ndryshe janë të dëmshme.

1.8 Jini gjithëpërfshirës dhe mos bëni diskriminim: Ne nuk do të përfshihemi dhe nuk do të tolerojmë asnjë formë të diskriminimit⁶, përfshirë atë nga ata që mbështesin punën tonë. Ne do të përpiqemi të përfshijmë dhe të krijojmë kushte të arsyeshme⁷ për ata që shpesh përjashtohen ose heshten për shkak të persekutimit, marginalizimit, supozimit se nuk kanë aftësi për të vepruar ose kapacitet, ose që anashkalohen si viktimë.

PARIMI 2: RESPEKTONI KONTROLLIN DHE AUTONOMINË E TË MBIJETUARIT/ES

2.1 Shmangni kontaktin e papritur me të mbijetuarit/at: Sa herë që është e mundur, ne do të punojmë përmes pikave ekzistuese dhe të verifikuara të qasjes ose referimit, ose do të krijojmë rrugë të sigurta në mënyrë që një i/e mbijetuar të vendosë vetë nëse do të na afrohet neve ose të vë kontakt me ne. Ne e kuptojmë se kur u afrohem të mbijetuarve/ave, qoftë vetë apo përmes dikujt tjetër (në vend që të krijojmë mënyra të sigurta që një i/e mbijetuar të vendosë të vijë tek ne), mund të rrisë rreziqet e dëmit dhe t'u bëjë presion të mbijetuarve/ave për të bashkëpunuar, duke zvogëluar kështu mundësinë për një zgjedhje vërtetë të lirë.

2.2 Respektoni zgjedhjet e të mbijetuarit/es: Ne respektojmë zgjedhjet individuale të një të mbijetuarit/e si bazë themelore për të gjitha aspektet dhe fazat e ndërveprimit tonë. Ne do të sigurojmë që një i/e mbijetuar të ketë informacion të plotë, të qartë dhe të sigurt rreth angazhimit dhe qëllimit tonë, metodologjisë sonë, si dhe opsioneve, të drejtave dhe rreziqeve të tyre, duke përfshirë konfidencialitetin dhe mosidentifikimin, përdorimin, ndarjen ose publikimin e informacionit të tyre. Ne do ta ofrojmë këtë informacion në një format të kuptueshëm dhe të qasshëm për të mbijetuarin/en, në mënyrë që ata/ato të marrin vendime të informuara nëse do të angazhohen me ne apo jo, dhe me çfarë kushtesh. Ne do të jemi të qartë me të mbijetuarit/at se ata/ato mund të pauzojnë ose të përfundojnë çdo ndërveprim me ne, dhe të vendosin të mos përgjigjen në çfarëdo pyetje të veçantë. Ne do të respektojmë vendimin e një të mbijetuarit/e për të mos marrë pjesë ose për të mos vazhduar.

⁷ **Akomodim i arsyeshëm** do të thotë "modifikime dhe përshtatje të nevojshme dhe të përshtatshme që nuk vendosin ndonjë barrë joproporcionale ose të papërshtatshme, kur është e nevojshme në një rast të caktuar, për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë ose të ushtrojnë në mënyrë të barabartë me të tjerët, të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut" (Neni 2, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, 2006).

2.3 Kontrolli i të mbijetuarve/ave mbi informacionet e tyre: Ne do të respektojmë dhe mbështesim të drejtën e një të mbijetuarit/e në privatësi, të cilën ne e kuptojmë se përfshinë kontrollin dhe autonominë mbi historinë e tyre personale, identitetin dhe imazhin. Ne do të mbrojmë çdo informacion ose të dhënë personale të të mbijetuarit/es (pavarësisht formës së tyre) si konfidenciale. Nuk do të përdorim ose ndajmë atë informacion pa pëlqimin e tyre të informuar dhe të shprehur qartë.

2.4 Vendimmarrje e mbështetur: Aty ku mund të ketë kufizime në mundësinë tonë për të përcaktuar zgjedhjen e një të mbijetuarit/e, për shembull për shkak të aftësive të kufizuara intelektuale ose kognitive apo vështirësive në komunikim, ne do bëjmë akomodim të arsyeshëm⁷ për të mbështetur autonominë e një të mbijetuarit/e dhe pjesëmarrjen në proceset vendimmarrëse të cilat bazohen në vullnetin dhe preferencat e tyre.

2.5 Procesi i vendimmarrjes me fëmijët: Ne do të mbështesim të drejtën e fëmijës për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes. Ne do të bëjmë një vlerësim profesional të aftësisë së fëmijës për të marrë pjesë (duke marrë parasysh moshën, pjekurinë, kapacitetet në zhvillim, traumën dhe përvojën, gjininë dhe mjedisin/situatën e tyre), do të ndjekim katër parimet udhëzuese në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës⁸ dhe të kuptojmë se çfarë mund të kërkohej me ligj për sa i përket rolit të kujdestarëve.

2.6 Ulni presionet: Ne do të zbusim në mënyrë proaktive faktorët që mund të bëjnë presion ndaj të mbijetuarve/ave për të ndarë informacionet. Faktorë të tillë përfshijnë pabarazi reale ose të perceptuara në pushtet, status, gjini ose moshë, dhe etiketë shoqërore, politizim ose ndikim nga familja dhe komuniteti (duke pranuar gjithashtu se shqetësimet për komunitetin e tyre mund të jenë motivues pozitivë për të mbijetuarit/at). Ne nuk do të përdorim asnjë autoritet ligjor që mund të kemi për të detyruar të mbijetuarit/at pasi kjo mund t'i dëmtojë ata/ato si dhe proceset dhe rezultatet e drejtësisë.

2.7 Mos ofroni përfitime në këmbim të informacionit: Ne nuk do të kushtëzojmë apo premtojmë (drejtpërdrejt ose në mënyrë të nënkuptuar) qasje në ndihmë, asistencë, mbrojtje ose përfitime tjera në këmbim të pranimi të së një të mbijetuarit/e për të na dhënë informacione. Megjithatë, ne do të përpiqemi të heqim çdo kosto financiare ose tjetër për një të mbijetuar që na ndihmon. Ne nuk do të stimulojmë ose komercializojmë ndihmën e atyre që janë përreth të mbijetuarit/es, për të bërë presion ose për të kërkuar që një i/e mbijetuar të flasë me ne.

2.8 Siguroni pritshmëri realiste: Ne do t'u japim të mbijetuarve/ave informacione të sinqerta dhe realiste lidhur me mënyrat se si do të përdoren informacionet e tyre, si dhe rezultatet e synuara (duke përfshirë çdo faktor të jashtëm që mund të ndikojë në ato rezultate). Ne do të diskutojmë me

⁸ **Katër parimet udhëzuese** siç përcaktohen në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës:

- **Mosdiskriminimi** (Neni 2): “Ne do të sigurojmë që fëmijët të mos i nënshtrohen asnjë forme të diskriminimit gjatë punës sonë. Ne do të punojmë me fëmijët pa dallim të prindërve ose kujdestarit/es ligjor/e të fëmijës, racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, opinionit politik ose të tjera, prejardhjes kombëtare, etnike ose shoqërore, varfërisë, aftësisë së kufizuar, lindjes ose ndonjë statusi tjetër.”
- **Interesi më i mirë i fëmijës** (Neni 3): “Ne do të sigurojmë që interesi më i mirë i fëmijës të jetë konsiderata kryesore në të gjitha veprimet dhe vendimet që kanë të bëjnë me fëmijët.” Kjo kërkon një qasje në dy hapa për të balancuar interesin më të mirë të fëmijës me konsiderata të tjera.
- **E drejta për jetë, mbijetesë dhe zhvillim** (Neni 6): “Ne do të sigurojmë që angazhimi ynë me fëmijët të mos cenojë të drejtën e fëmijës për t'u zhvilluar në mënyrë optimale: fizikisht, mendërisht, shpirtërisht, moralisht dhe në aspektin shoqëror. Ne do të bëjmë vlerësimet e duhura të rrezikut dhe të gjitha përpjekjet për të zbutur çdo rrezik për jetën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës, përfshirë ofrimin e përgjigjes dhe mbështetjes së duhur.”
- **E drejta për të shprehur pikëpamjet dhe që ato të merren në konsideratë** (Neni 12): “Ne e pranojmë që një fëmijë që është në gjendje të formojë pikëpamjet e veta ka të drejtë t'i shprehë ato lirshëm në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të. Ne do të përpiqemi ta bëjmë procesin sa më pjesëmarrës dhe t'u japim peshën e duhur pikëpamjeve të fëmijës në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tij/saj. Ne po ashtu e pranojmë se e drejta e fëmijës për pjesëmarrje përfshin edhe të drejtën për të marrë informacione dhe këshilla në një mënyrë që është e ndjeshme ndaj fëmijëve dhe që njeh kapacitetet e zhvillimit të tij ose saj.”

të mbijetuarit/at se cilat janë pritshmëritë e tyre dhe do t'i mbështesim ata/ato që të marrin vendime bazuar në pritshmëri realiste.

2.9 Bëjini të qarta kufizimet: Ne do të jemi të qartë dhe të sigurtë me të mbijetuarit/at mbi atë se çfarë mund të bëjmë dhe çfarë nuk mund të bëjmë, çfarë mund të mbrojmë dhe çfarë nuk mundemi, si dhe ku janë kufizimet tona dhe kufijtë tonë profesionalë. Nëse nuk jemi në gjendje të përshtatim qasjen tonë për të përmbushur dëshirat e të mbijetuarit/es, ne do t'ua shpjegojmë arsyet. Në rastet kur jemi të detyruar të raportojmë ose të ndajmë informacionet e tyre (siç janë detyrimet për të raportuar krimet tek autoritetet, për të bërë zbulime për mbrojtjen ose për t'u përgjigjur ndaj situatave kërcënuese për jetën), ne do t'i diskutojmë këto paraprakisht me të mbijetuarin/en dhe do t'i japim kohën dhe hapësirën e duhur për të vendosur nëse dëshiron të vazhdojë të na jap informacione.

2.10 Respektoni tërheqjen e pëlqimit: Ne do të informojmë të mbijetuarit/at për të drejtën e tyre për të tërhequr pëlqimin në çdo kohë, gjatë ose pas procesit (duke përfshirë edhe gjatë çdo interviste), dhe mënyrën se si mund të na njoftojnë për këtë tërheqje. Ne do të jemi të qartë lidhur me veprimet që mund të ndërmarrim në rastin e tërheqjes së pëlqimit, si dhe për ato gjëra për të cilat kemi kontroll të kufizuar. Nëse tërhiqet pëlqimi, ne do të ndërmarrim hapat që kemi thënë se do të ndërmarrim.

PARIMI 3: JINI TË PËRGJEGJSHËM DHE ME INTEGRITET

3.1 Përgjegjësia e mbledhësve të informacionit: Ne e kuptojmë se zgjedhja e të mbijetuarit/es nuk zëvendëson vendimmarrjen e përgjegjshme nga ana e mbledhësve të informacionit. Ne e pranojmë se mund të krijohen rrethana kur vlerësimi ynë mbi kompetencat tona, sigurinë dhe rreziqe të tjera mund të na çojë në vendimin për të mos vazhduar, edhe kur një i/e mbijetuar është i/e gatshëm/me t'i pranojë këto rreziqe. Në rrethana të tilla, nëse tashmë jemi në kontakt me të mbijetuarin/en, do të diskutojmë me të shqetësimet tona, arsyet dhe çdo alternativë të mundshme.

3.2 Dinjiteti dhe respekti: Ne do t'i mbështesim të mbijetuarit/at me dinjitet, respekt, humanizëm, mirësjellje, vlerësim dhe si vendimmarrës/e.

3.3 Mos stigmatizoni: Ne do të ekzaminojmë dhe përballemi me kufizimet tona në kuptimin e këndvështrimeve dhe përvojave përtej atyre tonave personale; me paragjykimet, frikën, traumat dhe nxitësit tanë; si dhe me qëndrimet, paragjykimet dhe supozimet tona në lidhje me dhunën seksuale dhe të mbijetuarit/at. Ne nuk do t'u përcjellim të mbijetuarve/ave asnjë mesazh (nëpërmjet tonit, fjalëve, gjuhës së trupit ose veprimeve të tjera) që i fajëson, i turpëron, i dëmton më tej, i gjykon, i nënçmon, i patronizon, i përqesh apo nuk i respekton ata/ato. Gjithashtu ne nuk do të paraqesim ose publikojmë asnjë informacion rreth tyre që do të mund të sjellë pasoja të tilla.

3.4 Siguroni saktësi: Ne do të kontrollojmë që të kuptuarit dhe paraqitja nga ne e informacionit të mbledhur të jetë e saktë dhe pa keqinterpretime ose supozime. Kurdoherë që të jetë e mundur, ne do të kontrollojmë saktësinë me të mbijetuarin/en dhe do të bëjmë çdo korrigjim të nevojshëm.

3.5 Mos i shfrytëzoni të mbijetuarit/at: Ne nuk do të jemi përfitues, nuk do t'i përdorim, shfrytëzojmë, abuzojmë, ngacmojmë apo të përfitojmë nga të mbijetuarit/at dhe informacionet e tyre. Ne do të marrim masa për të parandaluar dhe reaguar ndaj çdo forme të riviktimizimit, shfrytëzimit seksual apo abuzimit.

3.6 Jini të besueshëm: Ne nuk do bëjmë premtime të cilat mund të mos jemi në gjendje t'i mbajmë. Ne e pranojmë se shkelja e besimit, përfshirë konfidencialitetin, ka pasoja më të gjera për sigurinë dhe mirëqenien e të mbijetuarve/ave, duke ulur besimin tek të tjerët dhe duke krijuar pengesa për marrjen e mbështetjes.

3.7 Mos dëmtoni provat e mundshme: Ne nuk do të marrim ose largojmë dokumente origjinale, gjësende fizike apo prova të tjera të mundshme nga një i/e mbijetuar ose nga një vendndodhje, edhe nëse na kërkohet ta bëjmë këtë, përveç nëse kemi mandatin, është e domosdoshme ta bëjmë këtë, mund ta bëjmë në mënyrë të sigurt, nuk është askush në pozitë dhe rol më të përshtatshëm për ta bërë këtë, dhe nëse ne kemi kapacitetin për të menaxhuar dhe ruajtur integritetin e provave të tilla.

3.8 Jini të përgjegjshëm: Ne do të jemi transparentë dhe të përgjegjshëm ndaj angazhimeve të pasqyruara në këtë Kod. Ne i kuptojmë dëmet e mundshme për të mbijetuarin/en, familjen dhe komunitetin e tij/saj nëse ne nuk u përmbahemi këtyre angazhimeve. Ne e njohim të drejtën e një të mbijetuarit/e për të paraqitur ankesë, duke përfshirë edhe tek të tjerët, lidhur me punën tonë dhe do t'i dëgjojmë kur ai/ajo dëshiron të ankohet drejtpërdrejt tek ne. Ne do të jemi të hapur ndaj komenteve dhe sugjerimeve për të përmirësuar punën tonë.

PARIMI 4. SHTONI VLERË OSE MOS E BËNI FARE

4.1 Merrni vendime të përgjegjshme: Ne do të vlerësojmë elementet e këtij Parimi për të mbështetur marrjen e vendimeve të përgjegjshme lidhur me nëse, kur dhe si të kryejmë këtë punë. Ne e pranojmë se vetëvlerësimet tona mund të përfitojnë nga konsultimi me të tjerët, siç janë aktorët me bazë në komunitet dhe ekspertët e jashtëm, për të vlerësuar në mënyrë të sinqertë nëse puna jonë dhe metodat tona të synuara do të jenë të sigurta, efektive dhe me vlerë të shtuar për të mbijetuarit/at.

4.2 Cili është roli dhe qëllimi ynë?: Ne do të jemi të sinqertë dhe të qartë për qëllimin dhe rolin tonë; kufizimet dhe kufijtë e rolit tonë; pse synojmë të mbledhim informacione nga të mbijetuarit/at; çfarë informacionesh na nevojiten në të vërtetë, nga kush dhe në çfarë forme; si synojmë të përdorim informacionet dhe me kë mund të ndajmë ato për këtë qëllim.

4.3 A ka burime alternative?: Ne do të kërkojmë burime alternative të informacionit mbi dhunën seksuale të ndërlidhur me konfliktin (DhSSK) dhe do të pyesim veten nëse mandati ose qëllimi ynë kërkon me të vërtetë që ne të intervistojmë të mbijetuarit/at ose të përdorim informacionin e marrë prej tyre. Ne e pranojmë se gjetja e burimeve alternative i largon rreziqet e mundshme për të mbijetuarit/at, për ata përreth tyre dhe për veten tonë, nga mbledhja e një informacioni të tillë drejtpërdrejt nga të mbijetuarit/at, e heq presionin nga të mbijetuarit/at dhe u jep atyre më shumë hapësirë për të zgjedhur nëse duan apo jo të marrin pjesë.

4.4 A janë realiste rezultatet tona të synuara?: Ne do të ndërmarrim këtë punë vetëm kur qëllimi ynë mund të arrihet realisht në atë mjedis, me burimet, kohën dhe aftësitë tona, pa shkaktuar dëm.

4.5 A do të sjellim vlerë të shtuar?: Ne do të reflektojmë në mënyrë të sinqertë mbi atë se çfarë vlere të shtuar ose përfitimi mund të sjellë puna apo veprimet tona për të mbijetuarit/at. Ne do t'i diskutojmë këto me të mbijetuarit/at. Ne do të vazhdojmë vetëm nëse ka një vlerë të tillë të shtuar nga puna jonë. Ne e pranojmë se disa të mbijetuar/a janë të motivuar/a nga vlera e shtuar që puna jonë mund të sjellë për familjet, komunitetet apo grupet e tyre.

4.6 Vlerësoni vlerën e shtuar kundrejt rreziqeve: Ne do të vlerësojmë me kujdes çdo vlerë të mundshme të shtuar në raport me të kuptuarit tonë të rreziqeve. Ne do të hartojmë metodologji fleksibile që minimizojnë rrezikun dhe janë të përshtatshme për qëllimin.

4.7 Sfidoni shtytësit e praktikave të këqija: Ne do të shqyrtojmë në mënyrë kritike çdo presion ose arsyetim që lidhet me 'urgjencën', 'interesin publik', synimet sasiore, 'parandalimin' apo motive tjera të ngjashme për të vazhduar me punën aty ku nuk mund ta bëjmë këtë në mënyrë të sigurt, efektive dhe etike.

4.8 Minimizoni rreziqet e ekspozimit: Ne do ta pyesim të mbijetuarin/en nëse ka dhënë më parë intervista apo ka ndarë informacionin, dhe do të diskutojmë me të mbijetuarin/en për rreziqet e vazhdimit si dhe opsionet alternative. Rreziqe të tilla përfshijnë krijimin e rrëfimeve jokonsistente që mund të dëmtojnë të drejtën e të mbijetuarit/es për qasje në drejtësi, si dhe ekspozimin e mëtejshëm ndaj ritraumatizimit të mundshëm, humbjes së privatësisë dhe stigmatizimit. Ne do të diskutojmë me të mbijetuarin/en mundësinë për qasjen në deklaratat e mëparshme si një opsion ose si alternativë ndaj riintervistimit. Nëse i/e mbijetuar/a zgjedh të vazhdojë me intervistën, ne do të minimizojmë në mënyrë proaktive rreziqet e riintervistimit.

4.9 Ndarja e informacionit: Ne do të diskutojmë me të mbijetuarin/en nëse dëshirojnë që ne të ndajmë informacionin e tyre me aktorë të tjerë të besueshëm për të shmangur çdo dyfishim të panevojshëm të mbledhjes së informacionit ose ekspozim ndaj traumës së mëtejshme ose rreziqeve të tjera nga angazhimi i mëtejshëm i drejtpërdrejtë. Ne do të sigurohemi që çdo vendim i të

mbijetuarit/es për të ndarë informacionin të jetë i bazuar në pëlqimin e informuar, të mbështetur dhe të informuar nga një vlerësim i rrezikut, dhe të zbatohet në mënyrë të sigurt, efektive dhe në përputhje me dëshirat e të mbijetuarit/es.

4.10 Minimizimi i të dhënave: Ne do të mbledhim, ruajmë dhe përdorim informacionet personale të të mbijetuarit/es, duke përfshirë informacionin digjital, nëse kjo është e justifikuar për një qëllim të qartë, është e nevojshme për arritjen e këtij qëllimi dhe është në proporcion me aftësinë për të përmbushur atë qëllim, dhe nëse jemi në gjendje ta mbrojmë atë informacion.

PARIMET E PËRGATITJES

Këto parime duhet të zbatohen gjatë fazës përgatitore para mbledhjes së informacionit dhe të rishikohen gjatë fazave të zbatimit. Ato duhet të lexohen së bashku me të gjitha parimet e tjera.

PARIMI 5. PËRGATITJA ËSHTË BAZA

5.1 Së pari përgatituni: Ne do të bëjmë planifikim të detajuar dhe vlerësime të rrezikut dhe do të sigurohemi që njohuritë, kapacitetet, ekipi, politikat dhe procedurat e nevojshme të jenë të përcaktuara para se të fillojmë mbledhjen e informacionit, veçanërisht përpara çdo angazhimi me të mbijetuarit/at. Kjo është një bazë thelbësore për të respektuar të drejtat e të mbijetuarve/ave dhe për të arritur rezultate të sigurta, të qasshme, etike dhe efektive.

5.2 Siguroni fleksibilitet për zgjedhjet e të mbijetuarve/ave: Ne do të zhvillojmë një metodologji dhe do të formojmë një ekip sa më fleksibil që të jetë e mundur, për të mbështetur zgjedhjet e të mbijetuarve/ave lidhur me mënyrën se si të angazhohen me ne, ku dhe me kë (gjinia, moshë, përkatësia, etj.).

5.3 Vlerësoni dhe zbutni rreziqet: Bazuar në njohuritë dhe të kuptuarit e kontekstit, ne do të identifikojmë dhe vlerësojmë çdo rrezik potencial për të gjithë ata/ato që janë të përfshirë/a, si p.sh. të mbijetuarit/at individualë, familjet dhe komunitetet e tyre, për ne vetë dhe për të tjerët të përfshirë në proces. Ne do të vlerësojmë rreziqet e përgjithshme dhe specifike për individë dhe situata të caktuara, siç janë konfidencialiteti, siguria, mirëqenia, pasojat shoqërore dhe stigma, dhe të drejtat ligjore.⁶ Ne e pranojmë se ky proces duhet të udhëhiqet nga persona me kompetencë për aspekte si gjinia, fëmijët dhe komunikimi, si dhe siguria fizike, e të dhënave dhe në aspekte të tjera të sigurisë. Nëse ne vazhdojmë të punojmë me të mbijetuarit/at individualë, ne do të kërkojmë edhe mendimin e të mbijetuarit/es për rreziqet që i shohin. Ne nuk do të vazhdojmë nëse rreziqet nuk mund të zbuten në mënyrë të duhur. Ky vlerësim dhe masat për zbutjen e tij do të udhëheqin çdo aspekt të punës sonë. Ne do ta rishikojmë vlerësimin sa herë që të jetë e nevojshme.

5.4 Ndërveprimet në distancë: Ne do të sigurohemi se i kuptojmë sfidat dhe rreziqet unike të ndërveprimeve online dhe ndërveprimeve të tjera në distancë me të mbijetuarit/at. Këto përfshijnë sfidat në lidhje me përgatitjet; komunikimet dhe sigurinë e të dhënave; qasjen e të mbijetuarit/es në teknologji; verifikimin e personave që na ndihmojnë në vendndodhjen e të mbijetuarit/es, përfshirë ndërmjetësuesit dhe përkthyesit; monitorimin e niveleve të mirëqenies dhe rehatisë së të mbijetuarit/es; dhe sigurimin e sistemeve të sigurta për reagim emergjent në vendndodhjen e të mbijetuarit/es. Ne e pranojmë që ekzistojnë rreziqe serioze që mund të sjellin intervistat në distancë me të mbijetuarit/at që mund të përballen me rrezik të shtuar të dëmtimit, përfshirë fëmijët. Nëse nuk mund t'i adresojmë si duhet sfidat dhe rreziqet e tilla, ne nuk do të vazhdojmë me ndërveprime në distancë.

5.5 Kuptoni se kush tjetër po mbledh informacion: Ne do të informohemi se kush tjetër është duke mbledhur informacione nga ose rreth të mbijetuarve/ave dhe për çfarë qëllimesh, në mënyrë që të vlerësojmë nëse puna jonë është e nevojshme dhe do të sjellë vlerë të shtuar, dhe si bazë për bashkërendim dhe bashkëpunim.

5.6 Informohuni për mbështetjen në dispozicion: Ne do të identifikojmë shërbimet, pikat e qasjes dhe grupet e të mbijetuarve/ave (formale dhe joformale) për mbështetjen e të mbijetuarve/ave, duke përfshirë, së paku, shërbimet mjekësore, psiko-sociale, mbrojtjen, mbrojtësit e të mbijetuarve/ave dhe shërbime të tjera ligjore. Nëse janë në dispozicion, ne do të marrim parasysh

listat ekzistuese të këtyre aktorëve dhe pikat e qasjes ('hartëzimi'). Ne do të vlerësojmë nëse këto janë të qasshme, të sigurta, konfidenciale, efektive dhe të përshtatshme për të mbijetuarit/at e moshave, aftësive të kufizuara, gjinive, etj., të ndryshme. Ne do të identifikojmë dhe zvogëlojmë pengesat e të mbijetuarve/ave për qasje në mbështetje, sa herë që të jetë e mundur.

5.7 Koordinoni dhe bashkëpunoni: Ne e njohim rëndësinë e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërsektorial për të parandaluar dëmin e mëtutjeshëm, ekspozimin e tepruar të të mbijetuarve/ave dhe ndikimet negative në të drejtat e tyre që mund të vijnë nga efektet kumulative të punës sonë. Kurdo që është e përshtatshme, ne do të kontaktojmë me të tjerët që punojnë në të njëjtat çështje, përfshirë aktorët humanitarë dhe organizatat me bazë në komunitet, për të kërkuar mënyra të sigurta për të punuar së bashku ose për të ulur rreziqet e minimumit të punës së njëri-tjetrit.

5.8 Përgatituni për rrëfime të papritura: Ne e kuptojmë se një person mund të vendosë të rrëfejë dhunën seksuale kur ne nuk e presim atë ose nuk e kemi ndërmend të pyesim për të. Ne do të përgatitemi për këtë mundësi.

5.9 Mundësoni vazhdimin pas ndërveprimit: Ne e kuptojmë se komunikimi ndërmjet të mbijetuarve/ave dhe mbledhësve të informacionit pas ndërveprimit të tyre mund të jetë thelbësor për arsye të tilla si ndarja e çdo shqetësimi që rezulton për sigurinë, tërheqja ose rinovimi i pëlqimit dhe dhënia e komenteve kthyes nga të mbijetuarit/at për progresin dhe rezultatet. Ne do të përpiqemi të krijojmë një mënyrë efektive dhe të sigurt për të komunikuar. Nëse nuk mundemi, do të diskutojmë paraprakisht me të mbijetuarin/en arsyen se pse nuk mundemi. Për të mbijetuarit/at fëmijë, ne do të marrim masa specifike për të mundësuar kontaktin me një kujdestar/e të fëmijës, me mbështetjen e një eksperti/e për mbrojtjen e fëmijëve kurdo që të jetë e mundur.

5.10 Informoni ekipin dhe partnerët tuaj: Ne do të informojmë dhe monitorojmë ekipin tonë dhe ata që veprojnë në emrin tonë (duke përfshirë edhe çdo partner) lidhur me përgatitjet tona dhe për proceset e sigurta, etike dhe efektive për t'iu përmbajtur këtij Kodi.

PARIMI 6. NJIHNI DHE KUPTONI KONTEKSTET

6.1 Njihni kontekstin: Ne do të sigurohemi që ekipi ynë dhe ata që veprojnë në emrin tonë ta bazojnë punën e tyre në një kuptim të mirë të kontekstit në të cilin ka ndodhur DhSSK, si dhe të mjedisit të afërt rreth të mbijetuarit/es. Ne do të identifikojmë ndikimet pozitive dhe negative, të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të elementeve të këtij Parimi mbi të mbijetuarit/at, familjet dhe komunitetet e tyre, si dhe mbi punën tonë, dhe do të sigurohemi që ky kuptim të udhëheqë përgatitjet dhe punën tonë.

6.2 Kuptoni kulturën: Ne do të identifikojmë normat kulturore dhe shoqërore, qëndrimet, traditat, ritet dhe zakonet përkatëse, si dhe qëndrimet ndaj fëmijëve, vendimmarrjes së tyre dhe moshës madhore.

6.3 Kuptoni gjininë: Ne do të vlerësojmë dinamikat, normat, dhunën dhe pabarazitë gjinore, si dhe do të kuptojmë se si ato krijojnë rreziqe për riviktimizimin dhe barriera për mbështetjen e të mbijetuarve/ave dhe të drejtat e tjera.

6.4 Kuptoni stigmën ndaj DhSSK dhe të mbijetuarve/ave: Ne do të identifikojmë, vlerësojmë rreziqet dhe zbusim keqkuptimet, supozimet, qëndrimet dhe sjelljet e dëmshme (të njohur si 'stigma') brenda komuniteteve në lidhje me dhunën seksuale dhe të mbijetuarit/at.

6.5 Identifikoni dinamikat e komunitetit: Ne do të analizojmë dinamikat grupore përreth të mbijetuarve/ave, siç janë strukturat e pushtetit, konkurrenca për burime, politizimi i drejtësisë, motivimet e ndërmjetësve, kujdestarët e qasjes (ata që mund të kontrollojnë ose ndikojnë në qasjen të të mbijetuarit/at), ndikimet fuqizuese si dhe shtytësit që heshtin, ushtrojnë presion ose dëmtojnë të mbijetuarit/at dhe familjet e tyre.

6.6 Njihni dëmet individuale, të shumëfishta dhe kolektive: Ne do të analizojmë dëmet e ndryshme të ndërlidhura që u janë shkaktuar nga DhSSK individëve dhe në mënyrë kolektive grupeve siç janë familjet dhe komunitetet, dhe mënyrën se si dëmet përbëhen nga forma të shumta të diskriminimit.⁶

6.7 Njihuni me ligjet dhe praktikat: Ne do të njihemi me ligjet dhe praktikat përkatëse, si formale ashtu edhe joformale (përfshirë sistemet e trashëguara tradicionale). Ligjet dhe praktikat e tilla, për shembull, mund të ofrojnë rrugë për mjete juridike për të mbijetuarit/at, të diskriminojnë ose të përjetësojnë diskriminimin, të kriminalizojnë një të mbijetuar për atë që ka ndodhur, të mos e njohin një të mbijetuar si viktimë të një krimi, ose të kërkojnë ligjërisht që ne të raportojmë te autoritetet informacionet mbi krimet. Ne do t'i diskutojmë këto me të mbijetuarin/en para se ai/ajo të ndajë përvojën e vet, në mënyrë që të ketë mundësi të mendojë nëse dëshiron të vazhdojë apo jo, dhe si të vazhdojë.

6.8 Kuptoni komunikimin dhe ndërveprimet e përshtatshme: Ne do të punojmë për të kuptuar rëndësinë dhe ndikimin e të gjitha formave të komunikimit dhe ndërveprimeve tona në kontekstin përkatës, duke siguruar ndjeshmëri dhe respekt ndaj gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar, aspekteve shoqërore, kulturore dhe kontekstuale. Ne do të identifikojmë dhe përdorim forma gjithëpërfshirëse dhe jo të dëmshme të komunikimit që pasqyrojnë identitetet e të mbijetuarve/ave dhe që respektojnë normat dhe praktikat shoqërore që nuk janë të dëmshme. Ne gjithashtu do të përpiqemi të kuptojmë aspektet kulturore dhe të tjera të komunikimit, duke përfshirë sjelljet, termat nënçmues, shprehjet e zakonshme dhe eufemizmat si dhe boshllëqet gjuhësore që lidhen me DhSSK ose me të mbijetuarin/en.

6.9 Minimizimi i pasojave negative: Ne do të identifikojmë rreziqet dhe do të minimizojmë çdo pasojë negative që mund të shkaktohet nga puna jonë brenda një komuniteti.

6.10 Mbështetje e qëndrueshme e bazuar në komunitet: Ne e njohim rolin e rëndësishëm të grupeve të besueshme me bazë në komunitet dhe të sistemeve mbështetëse për vazhdimësinë e përkrahjes për të mbijetuarit/at, ndërtimin e marrëdhënieve të besueshme, fuqizimin e të mbijetuarve/ave dhe për trajtimin e qëndrimeve negative në komunitet ndaj të mbijetuarve/ave. Grupe të tilla mund të përfshijnë rrjetet e të mbijetuarve/ave, organizatat e grave, organizatat LGBTQI+, organizatat për fëmijë dhe organizatat për personat me aftësi të kufizuara. Kurdo që është e përshtatshme, ne do të përpiqemi të punojmë me grupe të tilla.

PARIMI 7. NDËRTONI SISTEME, AFTËSI DHE MBËSHTETJE

7.1 Përgjegjësitë dhe mbështetja institucionale: Ne e kuptojmë që këtë punë nuk e bëjmë të vetëm. Shumica prej nesh punojnë në ose për organizata. Në organizata, ne do ta zbatojmë këtë Kod përmes udhëheqjes dhe përkushtimit, politikave, proceseve dhe burimeve, përfshirë ato në lidhje me konsulentët.

7.2 Punoni me përgjegjësi si aktorë të pavarur: Kur punojmë në mënyrë të pavarur dhe nuk mund të bazohemi në mbështetjen institucionale, ne do të përpiqemi të sigurohemi që puna jonë të përkrahet nga sisteme dhe infrastruktura ekzistuese të sigurta të mbështetjes, si dhe nga individë dhe partnerë që ndajnë përkushtimin tonë sipas këtij Kodi.

7.3 Zgjidhni ekipin dhe partnerët e duhur: Ne do të ndërtojmë një ekip (duke përfshirë përkthyes, ndërmjetës, udhërrëfyes, ndihmës lolak) dhe do të përzgjedhim partnerë dhe të tjerë që veprojnë në emrin tonë, të cilët ndajnë përkushtimin tonë ndaj këtij Kodi. Ne po ashtu do të marrim parasysh diversitetin, përfaqësimin, konfidencialitetin, sigurinë dhe fleksibilitetin.

7.4 Ndërtoni kompetencat e duhura: Ne do ta bëjmë këtë punë vetëm aty ku kemi njohuritë e nevojshme, aftësi dhe qëndrime të dëshmuara brenda ekipit tonë. Këto kompetenca përfshijnë ndjeshmërinë ndaj dhunës seksuale dhe stigmës; të kuptuarit e gjinisë, diversitetit dhe kontekstit; punën me persona të gjinive të ndryshme, aftësive të kufizuara dhe moshave të ndryshme; dhënien e pëlqimit të informuar dhe aftësitë bazë për referim; njohjen e rrezikut; aftësi për komunikim dhe intervistim të sigurt, përfshirë me fëmijë dhe në intervista në distancë; ndërgjegjësim dhe kuptim mbi traumën; si dhe mbrojtjen dhe ruajtjen e informacionit. Ne do të mbajmë të përditësuar aftësitë dhe njohuritë që e bëjnë këtë punë të sigurt dhe efektive për qëllimin tonë të synuar.

7.5 Pranimi i kufizimeve tona: Ne e pranojmë që secili/la ka kufij në përvojën, ekspertizën dhe këndvështrimin e tij/saj, si dhe në rolin ose mandatin që mban. Ne do të reflektojmë në mënyrë të singertë dhe do të qëndrojmë brenda kufijve të njohurive, aftësive dhe të kuptuarit tonë. Përtej

kufizimeve tona, ne do të konsultohemi dhe do të punojmë me të tjerët, si ekspertë të traumës, sigurisë dhe fëmijëve.

7.6 Intervistimi i fëmijëve të mbijetuar: Duke pasur parasysh rreziqet e shtuara që lidhen me intervistat e pasigurta dhe joefektive me fëmijë, ne do të intervistojmë të mbijetuarit/at fëmijë vetëm nëse kemi dhe përdorim kompetenca, aftësi dhe përvojë të dëshmuar në punën me fëmijë (të përshtatur për moshën e tyre, kapacitetet zhvillimore, aftësitë, gjininë dhe nevojat). Nëse nuk i kemi këto kompetenca në ekipin tonë, ne do të përpiqemi t'i fitojmë ato ose të identifikojmë persona të tjerë që i kanë, në mënyrë që fëmijët që dëshirojnë të marrin pjesë, të mund ta bëjnë këtë në mënyrë të sigurt dhe efektive.

7.7 Siguroni mbështetjen e duhur: Ne do të vazhdojmë me punën vetëm kur të ketë mbështetje të përshtatshme dhe të qasshme, e cila mund t'u përgjigjet nevojave të të mbijetuarit/es. Kjo përfshin mbështetje mjekësore, psiko-sociale, mbrojtëse dhe ligjore. Ne do t'i diskutojmë këto mundësi me të mbijetuarin/en dhe do t'i ndihmojmë të referohen në mënyrë të sigurt nëse ata/ato zgjedhin. Nëse këto nevoja janë të menjëhershme, ne do t'i japim përparësi qasjes dhe referimeve përpara punës sonë. Ne do të hartojmë një plan të qartë për qasjen emergjente në mbështetje, në mënyrë që ajo të jetë e disponueshme përpara, gjatë ose pas ndërveprimit tonë me të mbijetuarin/en.

7.8 Ndërtoni mbrojtje të konfidencialitetit: Ne do të vendosim protokolle të konfidencialitetit dhe masa për të mbrojtur informacionin, privatësinë dhe sigurinë e të mbijetuarit/es, duke përfshirë kujdes të veçantë për të garantuar sigurinë e çdo komunikimi digjital, si dhe menaxhimin dhe ruajtjen e të dhënave.

7.9 Vazhdimësi dhe konsistencë: Ne do të përpiqemi të sigurojmë që i njëjti person të komunikojë me të mbijetuarit/at, për të ruajtur nivelet e besimit dhe rehatisë, si dhe për të minimizuar rreziqet që mund të vijnë nga ndërrimi i personelit. Ne do të diskutojmë me të mbijetuarin/en çdo kërkesë të tyre për të ndryshuar personelin ose personin e kontaktit dhe do ta respektojmë kërkesën e tyre.

7.10 Menaxhoni rreziqet e traumës së tërthortë: Ne do të sigurohemi që të kemi marrë masa për të minimizuar efektet e dëmshme të punës për veten tonë, ekipin tonë dhe për të tjerët të prekur. Ne do të sigurojmë trajnime bazë për shenjat dhe simptomat e traumës, traumës së tërthortë, lodhjen nga dhembshuria dhe djegien profesionale dhe do të sigurojmë protokolle mbështetëse institucionale dhe ekipore, si dhe metoda të sigurta të punës. Ne do të përfshijmë masa për të menaxhuar këto rreziqe edhe kur njerëzit punojnë jashtë ekipit ose ambientit të zyrës, përfshirë punën në distancë.

PARIMET E ZBATIMIT

Këto parime duhet të zbatohen që në fillim të mbledhjes së informacioneve. Megjithatë, ato duhet të lexohen së bashku me të gjitha parimet e tjera.

PARIMI 8. MBLEDHNI INFORMACIONE NGA BURIME TË TJERA

8.1 Kërkoni informacion për DhSSK që nuk vjen nga ose nuk ka të bëjë me të mbijetuarit/at: Ne e kuptojmë se informacionet e dobishme rreth DhSSK nuk vijnë gjithmonë nga, ose nuk ka të bëjë vetëm me një të mbijetuar. Ne do të përpiqemi të mbledhim dhe përdorim informacionet e tilla për DhSSK nga burime më të gjera (si statistikat, raportet ose analizat e ekspertëve, dhe informacioni mbi autorët e krimit) pasi ky lloj informacioni paraqet më pak rrezik për të mbijetuarit/at dhe mund të ndihmojë në shmangien e mbështetjes së tepruar vetëm në informacionin e të mbijetuarve/ave.

8.2 Siguroni informacion përfaqësues: Ne e kuptojmë që ajo se kush jemi, çfarë kërkojmë, si dhe ku kërkojmë mund të sjellë paragjykime të dëmshme dhe pika të padukshme në informacionin që gjejmë. Ne gjithashtu e pranojmë se paragjykime të ngjashme ndodhin për shkak të kufizimeve në disponueshmërinë e informacionit, p.sh. nëpërmjet censurës, pabarazive, marginalizimit shoqëror, pasigurisë dhe faktorëve teknikë. Ne do të përpiqemi t'i minimizojmë këto rreziqe.

8.3 Njihni të drejtat dhe rreziqet nga informacioni i marrë nga burime të tërthorta: Ne e pranojmë se ka implikime në privatësi, aspekte ligjore dhe të sigurisë nga mbledhja, pranimi ose përdorimi i informacionit të marrë në mënyrë të tërthortë nga ose për të mbijetuarit/at, edhe nëse ky

informacion është në domenin publik, në arkiva ose mund të merret nga burimet online (përfshirë ato publike dhe jopublike). Ne e kuptojmë se Kodi zbatohet edhe për mbledhjen dhe përdorimin e këtij lloj informacioni.

8.4 Verifikoni qëllimin e të mbijetuarit/es: Ne do të përpiqemi të verifikojmë informacionin për DhSSK të marrë nga burimi i tërthortë (përfshirë foto dhe video të të mbijetuarve/ave), përfshirë se ku, kur dhe si është marrë ky informacion, si dhe çfarë pëlqimi është dhënë nga të mbijetuarit/at për çfarë përdorimi të tij, si dhe qëllimin fillestar ose vullnetin për përdorimin e mëvonshëm nëse është ndarë nga vetë i/e mbijetuari/a. Nëse nuk mund të verifikojmë pëlqimin ose qëllimin e të mbijetuarit/es për përdorimin e informacionit të tyre për qëllimin tonë, ne nuk do ta përdorim ose ndajmë atë informacion nëse nuk mund t'i zbusim në mënyrë të duhur rreziqet dhe dëmet që lidhen me të.

8.5 Mos e minoni besimin në shërbimet humanitare: Ne do të respektojmë rëndësinë e konfidencialitetit dhe besimit në ofrimin e mbështetjes dhe kujdesit për të mbijetuarit/at, dhe nuk do të kërkojmë ose të ushtrojmë presion ndaj shërbimeve mbështetëse për të ndarë informacion për të cilin i/e mbijetuari/a nuk ka pranuar ta ndajë.

PARIMI 9. MERRNI KOHËN E NEVOJSHME, KRIJONI HAPËSIRË

9.1 Duhet të jeni të përgatitur/a: Ne e kuptojmë se puna me një të mbijetuar kërkon që ne të jemi të përgatitur për të dëgjuar me vëmendje të plotë dhe mendje të hapur pa supozime apo gjykime; pa ndikimin e reagimeve tona në ndërveprim; dhe të gatshëm për të ndërtuar besimin dhe për t'i dhënë të mbijetuarit/es kontroll mbi mënyrën se si ata/ato e tregojnë historinë e tyre. Nëse nuk jemi në këtë gjendje mendore, nuk do të vazhdojmë në atë moment.

9.2 Zvogëloni presionet kohore: Ne do të përpiqemi të eliminojmë presionet e kohës për të promovuar vendimmarrje vullnetare dhe të informuar, duke u mundësuar të mbijetuarve/ave të ndajnë informacionin e tyre në mënyrën dhe me ritmin që dëshirojnë. Ne e pranojmë se, ashtu si ndërveprimet e nxituara, edhe ndërveprimet e gjata mund të jenë një formë presioni dhe shkak shqetësimi për të mbijetuarit/at, veçanërisht për fëmijët. Nëse ka ndonjë afat të caktuar që një i/e mbijetuar duhet ta dijë për të ushtruar të drejtat e tij/saj, ne do ta diskutojmë këtë me të mbijetuarin/en.

9.3 Krijoni një mjedis mbështetës: Ne do të krijojmë një mjedis mbështetës, të sigurt në aspektin fizik dhe psikologjik, për ndërveprim ballë për ballë dhe për çdo ndërveprim në distancë, që është i qasshëm dhe i ndjeshëm ndaj gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar, faktorëve social, kulturor dhe kontekstit. Kjo është një bazë themelore për ndërtimin e besimit, rrëfimin e përvojave dhe marrjen e vendimeve nga të mbijetuarit/at.

9.4 Siguroni privatësinë: Në konsultim me të mbijetuarin/en, ne do të organizojmë një hapësirë private, diskrete, të qasshme dhe të sigurt për t'u takuar personalisht ose në distancë, dhe do të minimizojmë rrezikun e të qenit të vëzhguar (përfshirë gjatë hyrjes ose daljes nga vendi i takimit), të dëgjuar pa dashje ose të ndërprerë. Ne e respektojmë faktin që e drejta e një të mbijetuari/e për privatësi shtrihet në të gjitha komunikimet dhe kontaktet me ta/to, përfshirë para dhe pas çdo takimi.

9.5 Kush merr pjesë në intervistë: Ne do të përpiqemi të minimizojmë numrin e personave të pranishëm gjatë një interviste. Ne do të diskutojmë paraprakisht me të mbijetuarin/en se kë ka dëshirë që të ketë të pranishëm dhe kush mund të marrë pjesë nga ekipi ynë (duke dhënë informacione për rolin, gjininë, moshën dhe përkatësinë e tyre). Nëse nuk mund t'i përmbushim zgjedhjet e të mbijetuarit/es, përfshirë praninë e një personi mbështetës, kujdestari/e ose përfaqësuesi/e ligjor/e të jetë i/e pranishëm/me, ne do të diskutojmë me të arsyet për këtë dhe do të respektojmë zgjedhjen e tij/saj nëse vendos të mos vazhdojë.

9.6 Jepini përparësi sigurisë dhe cilësisë para sasisë: Ne nuk do të komprometojmë cilësinë, sigurinë ose mirëqenien për shkak të presionit për të kryer një numër të caktuar intervistash.

9.7 Kuptoni rrëfimet e vonuara dhe të pjesshme: Ne e pranojmë dhe e respektojmë se aftësia dhe vendimi i një të mbijetuari/e për të ndarë informacione ndihmohen nga besimi, koha dhe procesi i

shërimit, dhe si rrjedhojë mund të vijë në faza, me kalimin e kohës dhe përmes ndërveprimeve të ndryshme. Ne e kuptojmë që mospërputhjet midis rrëfimeve mund të lindin natyrshëm nga trauma, kujtesa, stigma, frika, presioni, kultura, pyetjet e bëra, interpretimi dhe perceptimi i dëgjuesit/es për atë që është thënë. Ne nuk do të bëjmë supozime mbi vërtetësinë bazuar në mospërputhje të tilla që lindin natyrshëm.

PARIMI 10. SIGURONI NDËRVEPRIME ME RESPEKT DHE TË SIGURTA

10.1 Vlerësoni dhe jini të vëmendshëm: Në fillim të një ndërveprimi, ne do të rivlerësojmë çështjet e sigurisë, privatësinë, nevojat e të mbijetuarit/es dhe mirëqenien e tij/saj, çdo mangësi në komunikim dhe çdo presion ndaj të mbijetuarit/es për të vazhduar. Ne do t'i monitorojmë këto çështje gjatë gjithë kohës. Ne do të vazhdojmë vetëm kur të jemi në gjendje të kuptojmë plotësisht dhe të kuptohemi plotësisht nga i/e mbijetuari/a. Kjo përfshin edhe sigurimin që çdo përkthyes/e që e përdorim të ketë ekspertizën për të punuar në gjuhën e të mbijetuarit/es dhe në gjuhën tonë.

10.2 Duhet të jeni të ndjeshëm ndaj traumës: Ne do të jemi në gjendje të njohim dhe të monitorojmë shenjat e traumës dhe shqetësimit, si dhe të dimë se kur dhe si të minimizojmë dhe t'u përgjigjemi efekteve potencialisht traumatizuese të një ndërveprimi. Ne e kuptojmë që trauma mund të ndikojë në radhën dhe ritmin me të cilin kujtohen dhe diskutohen ngjarjet.

10.3 Respektoni hapësirën personale: Ne do të jemi të kujdesshëm që të mos ndërhyjmë në hapësirën fizike të të mbijetuarit/es.

10.4 Krijoni një proces të sigurt intervistues: Ne do të sigurohemi që intervista jonë të ketë një proces dhe strukturë të sigurt dhe të ndjeshme. Ne do të sigurohemi që çdo pyetje lidhur me DhSSK të bëhet në mënyrë të sigurt brenda një procesi më të gjerë intervistimi. Ne do të marrim kohën e nevojshme për të përmbyllur një intervistë në mënyrë të sigurt dhe të kujdesshme, dhe do të shprehim mirënjohje për kohën dhe guximin e të mbijetuarit/es për të rrëfyer përvojën e tij/saj. Ne do të diskutojmë me të mbijetuarin/en se çfarë mund të pritet pas intervistës, mbështetjen në dispozicion dhe informacionin pasues.

10.5 Jepini të mbijetuarit/es kontroll mbi mënyrën se si ai/ajo e tregon historinë e tij/saj: Ne e respektojmë rëndësinë që ka kontrolli i të mbijetuarit/es mbi mënyrën se si ai/ajo e ndan përvojën e tij/saj. Ne do t'i krijojmë hapësirë të mbijetuarit/es që të shpjegojë atë që ka ndodhur në mënyrën e tij/saj me ritmin e tij/saj dhe do të dëgjojmë në mënyrë aktive. Ne do të rregullojmë ritmin dhe tonin e pyetjeve tona. Nuk do t'i nxitojmë të mbijetuarit/at pasi kjo krijon rreziqe më të mëdha për dëm dhe ritraumatizim dhe që informacioni i mbledhur të jetë jo i besueshëm ose i pasaktë.

10.6 Bëni pyetje të hapura: Ne (si intervistues dhe përkthyes) do të përdorim pyetje të hapura. Ne e pranojmë ndikimin potencialisht të dëmshëm që pyetjet e mbyllura mund të kenë mbi të mbijetuarin/en dhe në saktësinë dhe detajet e informacionit të mbledhur në atë mënyrë. Ne do të përdorim pyetje të tilla vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.

10.7 Vendoseni DhSSK në kontekst: Ne e pranojmë që DhSSK nuk ndodh e izoluar nga shkeljet dhe dëmet e tjera. Ne gjithashtu do të jemi të vëmendshëm dhe respektues nëse një i/e mbijetuar zgjedh të komunikojë për shkelje ose dëme të tjera që mund të ketë përjetuar ose parë.

10.8 Mos pyesni nëse nuk është e nevojshme: Ne nuk do të bëjmë pyetje ose të kërkojmë detaje eksplicite, të ndjeshme ose grafike lidhur me dhunën seksuale nëse nuk kemi nevojë specifike për qëllimin tonë. Nëse kemi nevojë për këtë lloj informacioni, ne do t'ia shpjegojmë të mbijetuarit/es arsyen dhe do të respektojmë vendimin e tij/saj nëse dëshiron apo jo të përgjigjet. Gjithashtu ne nuk do të fiksohemi ose të sensacionalizojmë detaje të tilla kur e përfaqësojmë ose raportojmë përvojën e një të mbijetuarit/e.